



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1493/8prot.

Datë 23.09.2022

V E N D I M
Nr. 919/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.09.2022 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Aldosch-Farma” shpk në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-26485-04-26-2022, me objekt: “B1-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezi Reanimacion, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskolo-skeletik, Sistemi nervor dhe Sistemi Respirator, Gjaku dhe organet formuese të gjakut”, ndarë në 113 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj”, Loti 31 Meropenem 1 gr me fond limit 61,325,799 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 03.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Incomed” shpk & “Edna Farma” shpk & “Albania Neë Farm” shpk & Partners Pharma” shpk
Zona Kadastrale 2376, Nr. Pasurie 103/17-ND dhe 103/17 Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Rruga e Kavajës Nr.1001, Tiranë

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Aldosch-Farma” shpk
Rruga “Myslim Keta”, Ish Antibiotiku Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.05.2022 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-26485-04-26-2022, me objekt: “B1-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezi Reanimacion, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskolo-skeletik, Sistemi nervor dhe Sistemi Respirator, Gjaku dhe organet formuese të gjakut”, ndarë në 113 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj”, Loti 31 Meropenem 1 gr me fond limit 61,325,799 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 03.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

II.2. Në datën 03.06.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 28.06.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- | | | |
|---|------------|---------------|
| - “Aldosch Farma” ShPK | 32.742.000 | I kualifikuar |
| - Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Incomed” shpk & “Edna Farma” shpk & “Albania Neë Farm” shpk & Partners Pharma” shpk | 60.754.600 | I kualifikuar |
| - “Rejsi Farma” ShPK | 61.191.160 | I kualifikua |

II.4. Në datën 04.07.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e **Njoftim-fituesi** në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.5. Në datën 12.07.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1493/2022 protokollin dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2354 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Incomed” shpk & “Edna Farma” shpk & “Albania Neë Farm” shpk & Partners Pharma” shpk duke kërkuar skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Aldosch-Farma” ShPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.5.1 Në ankesë ngrihen pretendime nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Incomed” shpk & “Edna Farma” shpk & “Albania Neë Farm” shpk & Partners Pharma” shpk si më poshtë vijon:

[...] në datë 04.05.2022 është publikuar në SPE proceura e mësipërme e prokurimit.

Operatori “Incomed” shpk ka paraqitur ofertën dhe dokumentat shoqëruese sipas kushteve dhe kriterëve të DST për Lot 31 Meropenem 1gr me nr. reference REF-26485-04-26-2022 si bashkim i operatorëve ekonomikë “Incomed” shpk & “Edna Farma” shpk & “Albania Neë Farm” shpk & Partners Pharma” shpk.

[...]Nëpërmjet kësaj ankese kërkohet të rishikohet dhe shqyrtohet edhe njëherë vlerësimi për lot 31Meropenem 1gr ku të shqyrtohet me përpikmëri pika 4 e kriteeve të veccanta të kualifikimit në DST në të cilin citohet: [...]

4. Për barnat e (listës së DST) të autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë duhet të paraqitet:

- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

/ose/

- autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.

Përsa më sipër ky kriter vendoset në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” i ndryshuar referojmë pikën 1 të tij [...] Në funksion të këtij argumentimi të mësipërm ku “1. Barnat që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë për përdorim njerëzor duhet të jenë të pajisuara me autorizim për tregtim nga Agjencia , mbështetur në studimet dhe analizat tonë pretendojmë se dokumenti i paraqitur nga oe “Aldosch-Farma” ShPK për produktin Meropenem nuk është dokumenti përfundimtar i duhuri për aplikim në këtë procedurë prokurimi konform pikës 4 të Kriterëve të Veçanata të Kualifikimit.

Referojmë Vendimin nr. 299 datë 08.04.20215 “Pëer miratimin e rregullores për dhënien e autorizimit të tregtimit të barnave të klasifikimit të tyre në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar me VKMnr. 790 datë 22.09.2015, nr. 432 datë 08.06.2016, nr. 579 datë 09.10.2018 (i përditësuar) i cili shpjegon hap pas hapi procedurat e regjistrimit dhe të pajisjes së barit me autorizim për tregtim (ccertifikata e regjistrimit përfundimtare e barit), neni 5 vlerësimi i dosjes referojmë pikat e paraqitura si më poshtë: 5[...]; 6[...]; 7 [...]; 8[...]; 10[...].

Bazuar në pikat e mësipërme ju lutem bëni vlerësimin e dokumentit i cili është aplikuar për këtë pikë nga oe “Aldosch-Farma” ShPK, a është konform kushteve të kërkuara të pikës 4?

Qartazi në nenin 10 citohet që aplikanti nuk mund të aplikojë për asnjë procedurë tjetër administrative lidhur me barin përse kohënuq është pajisur me ccertifikatën e autorizimit të tregtimit nga Agjencia. Tenderi është një procedurë administrative si ccdo mardhënie mée ent publik. Ritheksojmë se në procedurën e tenderit dokumentat e kërkuara janë:

- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore pra lloji i dokumentit “Vërtetim për barna të regjistruar për efekt tenderi lëshuar nga agjencia.

/ose/

- autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë, pra lloji i dokumentit “ccertifikata e autorizimit të tregtimit” lëshuar nga agjencia. Vetëm dy dokumentat e mësipërm janë të vlefshëm për plotësimin e pikës 4 (bashkangjitur dokumentacioni me të cilin ne kemi aplikuar.

Mosplotësimi i saktë i kushteve dhe kriterëve të DST, ashtu si mungesae një dokumenti edhe një dokumentacion jo i plotë dhe i parregullt konsiderohet kusht për skualifikim. Kjo është arsyeja që ne parashtrijmë dhe parasqesim këtë ankesë duke e konsideruar jo të rregullt vlerësimin e këtij loti duke shprehur kërkesën për rishqyrtim dhe vlerësimin e dokumentacionit me pretendimin që dokumenti i aplikuar nga oe “Aldosch-Farma” ShPK nuk është i duhuri.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 14932 datë 13.07.2022, lidhur me kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues bashkimi i operatorëve ekonomikë “Incomed” shpk & “Edna Farma” shpk & “Albania Neë Farm” shpk & Partners Pharma” shpk, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Aldosch-Farma” ShPK, pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Me shkresën nr.1532/125 prot., datë 22.07.2022, protokolluar me tonën nr.1493/3 prot., datë 29.07.2022, si dhe shkresës nr. 1532/143prot., datë 03.08.2022protokolluar me tonën nr. 1493/4prot datë 08.08.2022 autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, duke dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezultoi, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Incomed” shpk & “Edna Farma” shpk & “Albania Neë Farm” shpk & Partners Pharma” shpk dhe ka vendosur mospranimin të ankesës.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se në datën 15.07.2022 (nr. 1528prot.), operatori ekonomik “Aldosch-Farma” ShPK (formulari i ankesës së autoritetit kontraktor dhe komisionit të prokurimit publik), ka pasur pretendime në cilësinë e subjektit të interesuar, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

II.9. Në formularin e ankesës së autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ngrihen pretendime nga ana operatorit ekonomik “Aldosch-Farma” ShPK si më poshtë:

[...] Në faqen zyrtare të KPP-së datë 13.07.2022 nr. 1493/2prot u vumë në dijeni se BOE “Incomed” shpk & “Edna Farma” shpk & “Albania Neë Farm” shpk & Partners Pharma” shpk kanë ankimuar lidhur me pretendimet mbi kualifikimin e kompanisë “Aldosch-Farma” ShPK duke mrgitur pretendime se kjo kompani nuk ka përmbush kriteret si më poshtë:

Pika 2 kriteret e vecnat të kualifikimit

duhet të paraqitet:

- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

/ose/

- autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.

Kompania “Aldosch-Farma” ShPK si palë e interesuar në baë të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 113 “Të drejtat e operatorëve ekonomikë të interesuar” më poshtë po ju jep argumentimet me dokumenta faktike të cilat hedhin poshtë pretendimin e bashkimit të operatorëve “Incomed” shpk & “Edna Farma” shpk & “Albania Neë Farm” shpk & Partners Pharma” shpk .[...]

Për të kundështuar pretendimet e BOE "Incomed" shpk & "Edna Farma" shpk & "Albania Neë Farm" shpk & Partners Pharma" shpk, bashkëlidhur këtij formulari po ju vëmë në dispozicion kopje të dokumentit të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore nr. 2881/2 datë 17.05.2022 sipas urdhrorit të Ministres nr. 289 datë 05.05.2022 dokumenti i cili ky vërteton që bari në fjalë është i regjistruar në Republikën e Shqipërisë për të cilin kemi bërë dhe pagesën përkatëse (bashkëlidhur po ju vendosim kopje të mandatit pagesës). Ky dokument i përkthyer dhe noterizuar është ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik të APP-së në datën e ofertimit. Sa më sipër kërkojmë lënin në fuqi të vendimit të marrë nga komisioni i vlerësimit të ofertave e ofertës së operatorit ekonomik "Aldosch-Farma" ShPK dhe hedhjen poshtë të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë "Incomed" shpk & "Edna Farma" shpk & "Albania Neë Farm" shpk & Partners Pharma" shpk.[...]

II.10. Nëpërmjet shkresës me nr. 1493/5prot prot., datë 06.09.2022, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi Agjencisë Kombëtare për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore informacion si më poshtë vijon: "[...] Komisioni i Prokurimit Publik është duke shqyrtuar një ankesë të paraqitur nga një operator ekonomik, për një procedurë prokurimi me objekt "B1-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezi Reanimacion, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskolo-skeletik, Sistemi nervor dhe Sistemi Respirator, Gjaku dhe organet formuese të gjakut", ndarë në 113 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj", Loti 31 Meropenem 1 gr". Shoqëria "Aldosch-Farma" ShPK ka dorëzuar dokumentacion si me poshte vijon: Dokumentacionin (Autorizim marketingu për produktin mjekësor sipas urdhrorit të Ministrisë nr. 289 datë 05.05.2022), lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore nr. Referenca jonë: 2881/6 datë 17.05.2022. Për një shqyrtim sa më të drejtë të çështjes objekt-ankimi, kërkojmë nga ana juaj si institucion, të na informoni nëse dokumentacioni i mësipërm, konkretisht nr. Referenca jonë: 2881/6 datë 17.05.2022, konfirmon faktin se shoqëria "Aldosch-Farma" ShPK është e pajisur me autorizimin për tregtimin e barit "**Meropenem 1 gr**" në Republikën e Shqipërisë.

(Bashkëlidhur shkresa). Për vetë rëndësinë, që ka shqyrtimi në kohë të ankesave të operatorëve ekonomikë në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislativi i prokurimit publik, si dhe për një shqyrtim më të plotë e objektiv të ankesës, lutemi të na dërgoni kthim përgjigje për subjektin "Aldosch-Farma" ShPK[...]

II.11. Në datën 21.09.2022 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1493/7 prot., shkresa e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe të Pajisjeve Mjekësore me nr. 6550/1 prot., datë 16.09.2022 me objekt: "Kthim-përgjigje". Nëpërmjet kësaj shkrese informohet KPP-ja konkretisht (citojmë):

"[.....]Në përgjigje të shkresës suaj me Nr.Prot.1493/5, datë 05.09.2022 "Kërkesë për informacion" me protokoll hyrës Nr.Prot.6550, datë 07.09.2022, me anë të së cilës kërkohet informacion nga ana juaj në lidhje me autorizimin për tregtim për barin me princip aktiv "MEROPENEM x Ig" Ju sqarojmë si vijon:

Në Ligjin Nr.105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" të ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

Neni 3, pika 3: “Autorizim tregtimi” eshte dokumenti i leshuar nga Agjencia, i cili verteton se bari permbush standardet mbi sigurine, cilesine dhe efikasitetin.”

Neni 3, pika 51: “Mbijtes i Autorizimit te Tregtimit ” eshte Personi /tiri’dik ne emer te te cilit eshte lëshuar autorizimi i tregtimit te barit te gatshëm per perdorim. Ky subjekt eshte pergjegjies per cilesine, sigurine dhe efektshmerine e barit te gatshem per perdorim ne perputhje me informacionin e deklaruar per marrjen e autorizimit per treglim.”

- Neni 11, pika 1: “Barnat që vendosen ne treg ne Republikën e Shqiperise për përdorim njerezor duhet të jenë të pajisuara me autorizim për tretim nga Agjencia.

- Neni 12, pika 1 : “Aplikimi dhe praktika e dhenies se autorizimit te tregtimit kryhen prane Agjencise nga prodhuesit vendas të licencuar, mbajtësi i autorizimit për tregtim edhe kur ky nuk është prodhues i barit, sipas rregullave të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.

- Në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër, dhe bazuar në të dhënat e Regjistrit të Barnave të Autorizuara për Tregtim në RSH i publikuar në faqen zyrtare me adresë: ëëë.akbpm nov.al rezulton se:

Bari “MEROVIA” është i autorizuar për tregtim në RSH me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë Nr.289, datë 05.05.2022 në emër të Mbajtësit të Autorizimit të Tregtimit (MAH) kompanisë “REMEDINA S.A. - GREQI” me të dhënat si vijon:

EMRI TREGTAR	FORME - DOZA	PRINCI PI AKTIV	MAH	PAKETI MI	URDHERI I MINISTRIT/DATA
MEROVJA	Poëder for solution for injection /infusion x1000mg/vial	MEROPENEM TRIHYDRATE (eq. to MEROPENEM x lg)	Box x 10 vials	REMEDI A S.A.- GREQI	AUTORIZIM TREGTIMI 289/05.05.2022

Në vijim në VKM Nr.299 datë 08.04.2015 “Për miralimin e rregullores për dhënien e autorizimit të tregtimit të barnave e të klasifikimit të tyre në R5H’ të ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

Neni 3, pika 2: “Kerkesa per aplikim per dhenien e autorizimit te tregtimit per barna ne Republikën e Shqiperise dorezohet nga aplikanti si nje dokument origjinal ne gjuhen shqipe ose angleze dhe duhet te permbaje adresat e salaa te kontakteve te aplikantit.”

- Neni 3, pika 6: “Aplikanti autorizon personin përgjegjës për të ndjekur procedurat e përcaktuara në këtë rregullore, në anglisht ose shqip, i cili dorëzohet në Agjenci.”
- Neni 3, pika 7: “Personi përgjegjës që përfaqëson shoqëri, edhe te huaj, duhet te dorezoje nje deklarate me shkrim te mbajtesit te autorizimit te tregtimit qe nuk eshte me seli ne Republikën e Shqipërisë”.

Në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër, dhe bazuar në dokumentacionin e lëshuar nga Agjencia (të vënë në dispozicion edhe nga ana juaj në shkresë) me Nr.Prot.2881/6, datë 17.05.2022, rezulton se:

Shoqëria "ALDOSCH - FARMA" sh.p.k. me adresë: Rruga "Myslym Keta" Tiranë, është personi përejegjës i autorizuar nga MAH "REMEDINA S.A.- GREQI" për të ndjekur procedurat rregullatore për barnat në AKBPM (në kuptim të nenit 3, pika 6 dhe 7 të VKM-së si më sipër).

Për më tepër, në kuptim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.105/2014 të ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht se: "1.Barnat e autorizuar në Republikën e Shqipërisë importohen nga importuesit e autorizuar nga kompanitë mbajtëse të autorizimit të tregtimit, pas pajisjes me autorizim importi të lëshuar nga Agjencia, në bazë të regjistrit botuar të barnave-dhe; bazuar në dokumentin "Autorizim Prodhuesi" të datës 19.05.2022 rezulton se subjekti farmaceutik "ALDOSCH FARMA" sh.p.k. është importues i autorizuar në RSH, i kompanisë mbajtëse të autorizimit të tregtimit REMEDINA S.A.-GREQI.[...].

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë "Incomed" shpk & "Edna Farma" shpk & "Albania Neë Farm" shpk & Partners Pharma" shpk se: [...] në datë 04.05.2022 është publikuar në SPE proceura e mësipërme e prokurimit.

Operatori "Incomed" shpk ka paraqitur ofertën dhe dokumentat shoqëruese sipas kushteve dhe kriteve të DST për Lot 31 Meropenem Igr me nr. reference REF-26485-04-26-2022 si bashkim i operatorëve ekonomikë "Incomed" shpk & "Edna Farma" shpk & "Albania Neë Farm" shpk & Partners Pharma" shpk.

[..]Nëpërmjet kësaj ankese kërkohet të rishikohet dhe shqyrtohet edhe njëherë vlerësimi për lot 31Meropenem Igr ku të shqyrtohet me përpikmëri pika 4 e kriteve të veçanta të kualifikimit në DST në të cilin citohet: [...]

4. Për barnat e (listës së DST) të autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë duhet të paraqitet:

- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

/ose/

- autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.

Përsa më sipër ky kriter vendoset në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" i ndryshuar referojmë pikën 1 të tij [...]Në funksion të këtij argumentimi të mësipërm ku "1. Barnat që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë për përdorim njerëzor duhet të jenë të pajisuara me autorizim për tregtim nga Agjencia , mbështetur në studimet dhe analizat tonë pretendojmë se dokumenti i paraqitur nga oe

“Aldosch-Farma” ShPK për produktin Meropenem nuk është dokumenti përfundimtar i duhuri për aplikim në këtë procedurë prokurimi konform pikës 4 të Kriterëve të Veccanata të Kualifikimit.

Referojmë Vendimin nr. 299 datë 08.04.20215 “Pëer miratimin e rregullores për dhënien e autorizimit të tregtimit të barnave të klasifikimit të tyre në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar me VKMnr. 790 datë 22.09.2015, nr. 432 datë 08.06.2016, nr. 579 datë 09.10.2018 (i përditësuar) i cili shpjegon hap pas hapi procedurat e regjistrimit dhe të pajisjes së barit me autorizim për tregtim (ccertifikata e regjistrimit përfundimtare e barit), neni 5 vlerësimi i dosjes referojmë pikat e paraqitura si më poshtë: 5[...]; 6[...]; 7 [...]; 8[...]; 10[...];.

Bazuar në pikat e mësipërme ju lutem bëni vlerësimin e dokumentit i cili është aplikuar për këtë pikë nga oe “Aldosch-Farma” ShPK, a është konform kushteve të kërkuara të pikës 4?

Qartazi në nenin 10 citohet që aplikanti nuk mund të aplikojë për asnjë procedurë tjetër administrative lidhur me barin përse kohënjë është pajisur me ccertifikatën e autorizimit të tregtimit nga Agjencia. Tenderi është një procedurë administrative si ccdo mardhënie mëe ent publik. Ritheksojmë se në procedurën e tenderit dokumentat e kërkuara janë:

- *dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore pra lloji i dokumentit “Vërtetim për barna të regjistruar për efekt tenderi lëshuar nga agjencia.*

/ose/

- *autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë, pra lloji i dokumentit “ccertifikata e autorizimit të tregtimit” lëshuar nga agjencia. Vetëm dy dokumentat e mësipërm janë të vlefshëm për plotësimin e pikës 4 (bashkangjitur dokumentacioni me të cilin ne kemi aplikuar.*

Mosplotësimi i saktë i kushteve dhe kriterëve të DST, ashtu si mungesae një dokumenti edhe një dokumentacion jo i plotë dhe i parregullt konsiderohet kusht për skualifikim. Kjo është arsyeja që ne parashtrijmë dhe parasqesim këtë ankesë duke e konsideruar jo të rregullt vlerësimin e këtij loti duke shprehur kërkesën për rishqyrtim dhe vlerësimin e dokumentacionit me pretendimin që dokumenti i aplikuar nga oe “Aldosch-Farma” ShPK nuk është i duhuri.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 4, e dokumenteve të tenderit të publikuara në SPE, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

Për barnat (e listës së DST) të autorizuarra për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet:

- *dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore*

/ose/

- *autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.*

III.1.2. Në plotësim të kërkesë së sipërcituar, rezulton se operatori ekonomik “Aldosch-Farma” SHPK ka dorëzuar në SPE

Autorizim prodhuesi (noterizuar, përkthyer)

shkresën (autorizim marketingu për produktin mjekësor sipas urdhrit të Ministrit nr. 289 datë 05.05.2022), (noterizuar, përkthyer), me nr. 2881/6 prot., datë 17.05.2022 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Kombëtare për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore: “(autorizim marketingu për produktin mjekësor sipas urdhrit të Ministrit nr. 289 datë 05.05.2022”, bashkëngjitur tabela e produkteve mjekësore: Lot31 Merovia pluhur për solucion për injeksion /infuzionx 1000mg/vial, të autorizuara në Republikën e Shqipërisë nga mbajtësi i autorizimit të tregut “Demo Sa Pharmaceutical industry Greqi prodhuar nga Demo Sa Pharmaceutical industry Greqi.

III.1.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

III.1.4. Neni 40, pika 5, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

c) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

III.1.5. Në pikën 1 dhe 3 të nenit 11 të ligjit nr.105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Barnat që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë për përdorim njerëzor duhet të jenë të pajisura me autorizim për tregtim nga Agjencia. 3. Autorizimi është i vlefshëm për pesë vjet dhe është i rinovueshëm për periudha pesëvjeçare, me kërkesë së mbajtësit të autorizimit për tregtim.”

III.1.6. Në VKM-në nr. 299, datë 08.04.2015 “Për miratimin e rregullores për dhënien e autorizimit të tregtimit të barnave e të klasifikimit të tyre në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 5, pikat 5, 6, 7, 8 dhe 10 parashikohet si vijon:

5. Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale miraton, me urdhër, dhënien e autorizimit. Pas miratimit nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia njofton, zyrtarisht, aplikantin për dhënien e autorizimit për tregtim për barin, si dhe për tarifën përkatëse që duhet të paguhet.

6. Tarifa të paguhet jo më vonë se 40 ditë nga data e daljes së urdhrimit të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

7. Në rast se shoqëria nuk ka paguar tarifën përkatëse, brenda afatit kohor prej 45 ditësh, atëherë

Agjencia bën verifikimin brenda afateve kohore të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe përgatit propozimin për revokimin e autorizimit të tregtimit të barit, i cili dërgohet për miratim te ministri përgjegjës për shëndetësinë.

8. Brenda 30 ditëve, pas konfirmimit bankar të pagesës së tarifës përkatëse dhe dorëzimit të saj në

Agjenci, Agjencia lëshon certifikatën e autorizimit të tregtimit, sipas urdhrimit përkatës të ministrit të

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për çdo formë-dozë të barit, për të cilin është dhënë autorizimi për tregtim, i cili është i vlefshëm për 5 vjet, duke filluar nga data në të cilën është lëshuar urdhri i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

9. Për çdo ndryshim që i ndodh barit gjatë periudhës 5-vjeçare të autorizimit të tregtimit, aplikanti

është i detyruar ta paraqesë atë pranë Agjencisë, përpara procedurës së aplikimit për rinovim të autorizimit të tregtimit, nëse ky ndryshim është i aplikueshëm për Shqipërinë, sipas kapitullit për ndryshimet.

10. Aplikanti nuk mund të aplikojë për asnjë procedurë tjetër administrative lidhur me barin, për sa kohë 5 nuk është pajisur me certifikatën e autorizimit të tregtimit nga Agjencia.

III.1.7. Për një gjykim të drejtë dhe transparent të ankesës dhe verifikimin e pretendimeve të shoqërisë ankimuese, Komisioni i Prokurimit Publik, me shkresën shkresës me nr. 1493/5prot., datë 06.09.2022, i kërkoi Agjencisë Kombëtare për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore informacion (mbi dokumentacionin e paraqitur në tender nga shoqëria “Aldosch-Farma” ShPK) nëse vërtetimi Nr.Ref 2881/6 datë 17.05.2022, lëshuar nga Ministria e

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, Agjencia Kombëtare për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore, konfirmon faktin se shoqëria “Aldosch-Farma” ShPK) është e pajisur me autorizimin për tregtimin e barit “Meropenem” në Republikën e Shqipërisë. Në përgjigje të kërkesës së KPP-së, në datën 21.09.2022 është protokolluar pranë këtij komisioni me nr. 1493/7 prot., shkresa e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe të Pajisjeve Mjekësore me nr. 6550/1 prot., datë 16.09.2022 me objekt: “Kthim përgjigje”, nëpërmjet së cilës (citojmë): “[...]Bari “MEROVIA” është i autorizuar për tregtim në RSH me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë Nr.289, datë 05.05.2022 në emër të Mbajtësit të Autorizimit të Tregtimit (MAH) kompanisë “REMEDINA S.A.- GREQI” me të dhënat si vijon:

EMRI TREGTAR	FORME - DOZA	PRINCIPI AKTIV	MAH	PAKETIMI	URDHERI I MINISTRIT/DATA
MEROVJA	Powder for solution for injection /infusion x1000mg/vial	MEROPENEM TRIHYDRATE (eq. to MEROPENEM x lg)	Box x 10 vials	REMEDI N A S.A.- GREQI	AUTORIZIM TREGTIMI 289/05.05.20 22

Në vijim në VKM Nr.299 datë 08.04.2015 ”Për miralimin e rregullores për dhënien e autorizimit të tregtimit të barnave e të klasifikimit të tyre në R5H’ të ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

Neni 3, pika 2: “Kerkesa per aplikim per dhenien e autorizimit te tregtimit per barna ne Republikën e Shqiperise dorezohet nga aplikanti si nje dokument origjinal ne gjuhen shqipe ose angleze dhe duhet te permbaje adresat e salaa te kontakteve te aplikantit.”

- Neni 3, pika 6: “Aplikanti autorizon personin përgjegjës për të ndjekur procedurat e përcaktuara në këtë rregullore, në anglisht ose shqip, i cili dorëzohet në Agjenci.”
- Neni 3, pika 7: “Personi përgjegjës që përfaqëson shoqëri, edhe te huaj, duhet te dorëzoje nje deklaratë me shkrim te mbajtesit te autorizimit te tregtimit qe nuk eshte me seli ne Republikën e Shqipërisë”.

Në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër, dhe bazuar në dokumentacionin e lëshuar nga Agjencia (të vënë në dispozicion edhe nga ana juaj në shkresë) me Nr.Prot.2881/6, datë 17.05.2022, rezulton se:

Shoqëria ”ALDOSCH - FARMA” sh.p.k. me adresë: Rruga ”Myslym Keta” Tiranë, është personi përejegjës i autorizuar nga MAH “REMEDINA S.A.- GREQI” për të ndjekur procedurat rregullatore për barnat në AKBPM (në kuptim të nenit 3, pika 6 dhe 7 të VKM-së si më sipër).

Për më tepër, në kuptim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.105/2014 të ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht se: “1.Barnat e autorizuar në Republikën e Shqipërisë importohen nga importuesit e autorizuar nga kompanitë mbajtëse të autorizimit të tregtimit, pas pajisjes me autorizim importi të lëshuar nga Agjencia, në bazë të regjistrit botuar të barnave-dhe; bazuar në dokumentin “Autorizim Prodhuesi” të datës 19.05.2022 rezulton se subjekti farmaceutik “ALDOSCH FARMA”sh.p.k. është importues i autorizunr në RSH, i kompanisë mbajtëse të autorizimit të tregtimit REMEDINA S.A.-GREQI.[...].”

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë, se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor, përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në këto kushte, bazuar në faktin që në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar *se dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, duhet të jetë i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore./ose/ autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë*, rezulton që edhe dokumenti i paraqitur nga shoqëria “Aldosch Farma” SHPK për produktin në fjalë është pajisur me autorizim tregtimi që nga data 17.05.2022 dhe është i vlefshëm për një periudhë 5 vjeçare nga data 17.05.2022 e daljes së Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë. Gjithashtu, referuar përgjigjes së dhënë nga Agjencia Kombëtare për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore me shkresën nr. 1493/7 prot., datë 21.09.2022, shkresa e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe të Pajisjeve Mjekësore me nr. 6550/1 prot., datë 16.09.2022 me objekt: “Kthim përgjigje”, konfirmohet edhe njëherë fakti, se Autorizimi për Tregtim në Republikën e Shqipërisë me Nr.Ref 2881/6 datë 17.05.2022 është i vlefshëm për një periudhë 5 vjeçare nga data e daljes së Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik “Aldosch Farma” SHPK përmbush kriterin e kualifikimit në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik, pika 4 e dokumenteve të tenderit, të ngarkuar në SPE, si më sipër cituar.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të nenit 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të dispozitave ligjore të LPP-së dhe rregullave të prokurimit publik.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me çështjen administrative të paraqitur nga operatori ekonomik “Aldosch Farma” SHPK protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1528 datë 15.07.2022

(bashkëlidhur faturë nr. 378), KPP vëren se, operatori ekonomik ka paraqitur formularin e ankesës së autoritetit kontraktor dhe komisionit të prokurimit publik), në të cilin ka pasur pretendime në cilësinë e subjektit të interesuar, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nuk ka objekt përsa kohë pretendimet e mësipërme të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Incomed” shpk & “Edna Farma” shpk & “Albania New Farm” shpk & Partners Pharma” shpk në çështjen administrative nr. 1493 datë 14.08.2022, e cila u mor në shqyrtim në themel me arsyetimin si më sipër cituar dhe pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë. Akoma më tej referuar nenit 120 “Pagesa për ankimin” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin parashikohet se konkretisht citojmë: *“Me paraqitjen e ankesës, operatori ekonomik ankimues detyrohet të paguajë tarifën e kësaj ankese pranë Komisionit të Prokurimit Publik. 2. Me paraqitjen e ankesës, operatori/ët ekonomikë të interesuar, i cili/të cilët nuk është/janë dakord me vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor, detyrohet/detyrohen të paguajë/paguajnë tarifën e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. 3. Në çdo rast, pagesa e tarifës i kthehet operatorit ekonomik ankimues ose operatorit ekonomik të interesuar, i cili ka kundërshtuar vendimin e autoritetit ose entit kontraktor nëse ankesa e tyre është pranuar plotësisht ose pjesërisht brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. 4. Rregullat dhe tarifrat e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”*. Rrjedhimisht KPP gjykon se nuk ka më objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Incomed” shpk & “Edna Farma” shpk & “Albania Neë Farm” shpk & Partners Pharma” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-26485-04-26-2022, me objekt: “B1-Blerje barna Anti-infektive të përgjithshëm, Anestezi Reanimacion, Psikiatria, Sistemi kardiovaskular, Sistemi muskolo-skeletik, Sistemi nervor dhe Sistemi Respirator, Gjaku dhe organet formuese të gjakut”, ndarë në 113 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë

të përcaktuara - me afat 24 muaj”, Loti 31 Meropenem 1 gr me fond limit 61,325,799 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 03.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Incomed” shpk & “Edna Farma” shpk & “Albania Neë Farm” shpk & Partners Pharma” shpk.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Aldosch-Farma” shpk.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

